

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata e Apelit e Kosovës – Departamenti për Krime të Rënda, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Fillim Skoro kryetar, Xhevdet Abazi dhe Afrim Shala, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Syzana Goxhuli, procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të akuzuarve B.R. nga fsh. ..., Komuna e Malishevës dhe I.B. nga Prizreni, për shkak të veprës penale, për secilën veç e veç, shtytja në kryerjen e veprës terroriste nga neni 141 të KPRK-së, E.G. nga Peja dhe M.M. nga Prizreni, për shkak të veprës penale, për secilin veç e veç, nxitje e urrejtjes, përçarjes ose mos durimit kombëtar, racor, fetar etnik nga neni 147 par. 2 lidhur me par. 1 të KPRK-së, dhe i akuzuari F.R. nga Prishtina, për shkak të veprës penale thirrje për rezistencë nga neni 411 par. 1 të KPRK-së, duke vendosur përkitazi me ankesën e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, dhe përgjigjes në ankesë të mbrojtësit të akuzuarit M.M., av. B.T., të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore – DKR në Prishtinë, PKR.nr.510/16, të datës 18.05.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur konformë dispozitës së nenit 390 të KPPK, më datë 09.11.2018, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohen si të pabazuara ankesa e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, kurse, aktgjykimi i Gjykatës Themelore - DKR në Prishtinë, PKR.nr.510/16, të datës 18.05.2018, vërtetohet.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore - DKR në Prishtinë, me aktgjykimin PKR.nr.510/16, të datës 18.05.2018, të akuzuarit B.R., I.B., E.G., M.M. dhe F.R., bazuar në dispozitat e nenit 364 par.1 nën par.3 të KPPK, i ka liruar nga akuza për veprat penale dhe atë: të akuzuarit B.R. dhe I.B., për shkak të veprës penale, për secilën veç e veç, shtytja në kryerjen e veprës terroriste nga neni 141 të KPRK-së, të akuzuarit E.G. dhe M.M., për shkak të veprës penale, për secilin veç e veç, nxitje e urrejtjes, përçarjes ose mos durimit kombëtar, racor, fetar etnik nga neni 147 par. 2 lidhur me par. 1 të KPRK-së, dhe të akuzuarin F.R., për shkak të veprës penale thirrje për rezistencë nga neni 411 par. 1 të KPRK-së, me arsyetim se me provat e procedura në shqyrtimin gjyqësor nuk është vërtetuar se në veprimet e të akuzuarve përmbushën elementet e veprave penale në fjalë. Për shpenzimet e procedurës penale ka vendosur që të mbesin në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ankesë ka paraqitur Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të

plotë të gjendjes faktike dhe shkelje të ligjit penal, me propozim që aktgjykimi i ankimuar të anulohet dhe çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë, në rigjykim dhe vendosje.

Përgjigje në ankesë ka paraqitur, mbrojtësi i të akuzuarit M.M., av. B.T., me propozim që të refuzohet ankesa e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, ndërsa aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, të vërtetohet.

Gjykata e Apelit e Kosovës, seancën e kolegjit e caktoi konform dispozitës së nenit 390 par.1 të KPPK, për të cilën nuk janë njoftuar fare palët pasi që në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me aktgjykim ku është shqiptuar dënimi me burg, prandaj, njoftimi i palëve nuk është i obligueshëm.

Prokuroria e Apelit e Kosovës, me parashtresën PPA/l.nr.432/18, të dt. 19.09.2018, ka propozuar që ankesa e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, të aprovohet dhe aktgjykimi i shkallës së parë, të anulohet, ndërsa, çështja të kthehet në rigjykim dhe vendosje.

Gjykata e Apelit, pasi që shqyrtoi të gjitha shkresat e kësaj çështjeje penalo-juridike, studioi aktgjykimin e ankimuar në pajtim me dispozitën e nenit 394 të KPPK dhe pasi vlerësoi pretendimet e cekura në ankesë dhe përgjigjet në ankesë, gjeti se:

Ankesa nuk është e bazuar.

Pretendimet ankimore përkitazi me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe gjetjet e gjykatës.

Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës, në ankesë pretendon se aktgjykimi i ankimuar përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale të cilat qëndrojnë në faktin se i njëjti nuk përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare gjegjësisht ato që janë dhënë, janë të pa qarta dhe në masë të konsiderueshme në kundërtënie, sidomos përkitazi me faktet vendimtare, e po ashtu të njëjtat arsye janë në kundërshtim edhe me përmbajtjen e shkresave–provave të deponuara në këtë çështje penalo-juridike. Kështu, gjithë herë sipas pretendimeve ankimore, theksohet se gjykata e shkallës së parë, nuk ka dhënë arsye të plota përkitazi me këtë çështje penalo-juridike, sidomos përkitazi me ekzistimin e veprës penale dhe përgjegjësisë penale të akuzuarve, duke mos dhënë kështu vlerësimin e saktë se cilat fakte dhe rrethana i konsideron të vërtetuara e cilat fakte dhe rrethana i konsideron të pa vërtetuara, pastaj, nuk rezulton të jetë e qartë, pse deklaratave të dëshmitarëve nuk ua fali besimin, por u beson vetëm deklaratave të akuzuarve, pastaj, pse nuk i merr parasysh deklaratat e dëshmitarëve P.M. dhe N.H., deklarata këto të cilat janë në kundërshtim me deklaratat e të akuzuarve. Gjithashtu, gjithë herë sipas pretendimeve ankimore, nga deklaratat e dëshmitarëve në fjalë, pa mëdyshje vërtetohet se i akuzuari I.B. e njëj gjuhën shqipe, ndërsa, nga dëshmitari tjetër V.K. dhe B.K., vërtetohet se H.K. dhe Q.K., kanë përcjellë ligjëratat tek i akuzuari I.B., ndërsa, gjykata në arsyetim konstaton se i akuzuari I.B., nuk e ka folur gjuhën shqipe, që do të thotë se arsyerat për faktet vendimtare janë në kundërtënie të plotë me provat dhe shkresat tjera në lëndë në këtë çështje penale – juridike. Po ashtu, më tutje, në arsyetim pretendohet se në raport me të akuzuarin E.G., gjykata e shkallës së parë, i fali besimin vetëm deklaratës së dëshmitarit S.B., por nuk merr parasysh fare përgjigjen me shkrim të BIK, ku në një pjesë të saj konstatohet “Irrshëm mund të konstatohet se metodologjia islame e ligjërimit – predikimit bëhet me urtësi, këshillat e mira dhe në mënyrë afirmative e jo duke mbjellë urrejtje e përçarje në mes njerëzve, siç ka vepruar E.G., në ligjëratën e tij” që do të thotë se përkitazi me këtë të akuzuar kemi prova kundërtënese, kurse, gjykata e shkallës së parë, pa dhënë fare vlerësim adekuat për provat në fjalë apriori konstaton se me provat e proceduara nuk është vërtetuar se të akuzuarit kanë kryer veprën penale që me aktakuzë iu vihet në barrë. Prandaj, sipas pretendimeve ankimore, gjykata e shkallës së parë, ka bërë shkelje

esenciale të dispozitave të procedurës penale, kur të akuzuarit i ka liruar nga akuza për veprat penale që me aktakuzë iu vihen në barrë.

Gjykata e Apelit, gjen se nuk qëndrojnë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale të cekura si më lartë, por as që ka shkelje të tjera të cilat kjo gjykatë i vëren sipas detyrës zyrtare, e që kishin me kushtëzuar anulimin e aktgjykimit të shkallës së parë.

Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, nuk qëndrojnë pretendimet ankimore se aktgjykimi i ankimuar përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.1 nën par.12 të KPPK-së, ngase aktgjykimi i ankimuar duke përfshirë edhe arsyetimin, është i qartë dhe konkret, po ashtu përmban arsye të mjaftueshme për të gjitha faktet relevante në këtë çështje penalo-juridike dhe gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë dhe të plotë ka vërtetuar të gjitha faktet vendimtare dhe atë qasja ndaj fakteve vendimtare përveç që ka qenë e drejtë, objektive dhe e ligjshme, po ashtu ka mbështetje edhe në provat e proceduara në shqyrtimin gjyqësor, prandaj nuk qëndron pretendimi ankimor se të njëjtat nuk kanë mbështetje në provat e proceduara në seancën e shqyrtimit gjyqësor. Po ashtu, arsyetimi i aktgjykimit të ankimuar, përveç që ka mbështetje në deklaratat e të akuzuarve dhe provat materiale në shkresat e lëndës, i njëjti mbështetet edhe në deklaratat e dëshmitarëve dhe atë duke përfshirë edhe atë pjesë të deklaratave që janë në kundërtënie me deklaratat e të akuzuarve, por edhe vetë deklaratës së dëshmitarit, që do të thotë se gjykata e shkallës së parë, ka dhënë arsyet e veta edhe përkitazi me kundërtënie në fjalë dhe atë duke përfshirë kundërtënie të deklaratave të dëshmitarëve me ato të akuzuarve, por njëkohësisht edhe për kundërtënie në vetë deklaratën e dëshmitarit (pra, për kundërtënie të vetë dëshmitarit) dhe pasi ka bërë vlerësimin e kundërtënieve në fjalë duke i krahasuar njëkohësisht edhe me provat materiale, pastaj, gjykata e shkallës së parë, pasi ka bërë analizën për të gjitha provat, ka aprovuar konkludimet e saja e duke arsyetuar kështu aktgjykimin lirues, konkludime këto të cilat i aprovon edhe kjo gjykatë. Kështu, në rastin konkret, në këtë çështje penale-juridike gjykata e shkallës së parë, vlerësimin e saj e ka bazuar së pari në mbrojtjen e të akuzuarve, të cilët nuk i mohojnë faktet dhe rrethanat se në cilësinë e predikuesve fetar kanë mbajtur ligjëratat për qytetar të besimit islam dhe atë në vende dhe objekte të ndryshme por edhe në xhamia, e herë pas here edhe në vende të improvizuara si xhamia, dhe se në ligjëratat që i kanë mbajtur të akuzuarit kanë marrë pjesë qytetar të moshave të ndryshme, duke përfshirë edhe të rinj, ku disa nga pjesëmarrësit ka pasur edhe persona që më vonë kanë shkuar në Siri, dhe i janë bashkangjitur luftës, ku disa nga ta edhe kanë vdekur në luftë, disa të tjerë vazhdojnë ende të jenë pjesëtar të luftës në Siri, dhe atë në radhët e organizatës terroriste ISIS, ndërsa, e disa nga ata që janë kthyer në Kosovë, janë arrestuar dhe paraburgosur për shkak të pjesëmarrjes në luftërat e organizatave terroriste në Siri, fakte këto dhe rrethana që gjykata e shkallës së parë, i ka vërtetuar edhe nga deklaratat e dëshmitarëve V.K., B.K., P.M. dhe N.H.. Në arsyetimin e saj po ashtu, janë marrë parasysh edhe pretendimet në fjalë, pra, se disa nga pjesëmarrësit në ligjëratat kanë shkuar në Siri dhe i janë bashkangjitur organizatave të ndryshme terroriste, mirëpo, në bazë të provave të proceduara në seancën e shqyrtimit gjyqësor, gjykata e shkallës së parë, ka konstatuar se nuk ka gjetur se të akuzuarit kanë ndërmarrë ndonjë veprim konkret inkriminues e që të ketë ndikuar drejtë për së drejti tek personat në fjalë, e që pastaj, të njëjtit të jenë shtytur për pjesëmarrje në organizata terroriste. Kurse për formën dhe përmbajtjen e ligjëratave, që janë mbajtur nga të akuzuarit, pasi është vlerësuar përmbajtja e tyre, po ashtu, ka konstatuar se duke marrë parasysh përmbajtjen në fjalë nuk ka mund të vije në konkludim se pikërisht ligjëratat në fjalë të kenë ndikuar tek pjesëmarrësit e tubimeve që ata më pastaj t'i bashkangjiten organizatave terroriste. Po përkitazi me faktet dhe rrethanat në fjalë në këtë çështje penale-juridike, gjykata e shkallës së parë, ka marrë parasysh, përveç, deklaratës së dëshmitarit S.B., edhe provat materiale në shkresa të lëndës, nga të cilat ka vërtetuar edhe përmbajtjen e ligjëratave që i kanë ligjëruar të akuzuarit, duke konstatuar se të gjitha ligjëratat në fjalë kanë qenë komente të librit islam – kuranit apo edhe pjesë tjera të literaturës islame, e që faktet dhe rrethanat në fjalë janë vërtetuar edhe përmes video incizimeve në shkresa të lëndës, pastaj, foto dokumentacionit dhe atë sidomos edhe pjesëmarrja e qytetarëve, ku pastaj edhe është konstatuar se në bazë të përmbajtjes së ligjëratave në fjalë nuk mund të vërtetohet se të akuzuarit me veprimet e tyre kanë ndikuar në pjesëmarrësit që ata pastaj t'i bashkohen luftës në Siri. Pastaj, po për faktet vendimtare gjykata e shkallës së parë, nga provat

në fjalë por edhe deklaratat e vetë të akuzuarve ka vërtetuar edhe përmbajtjen e ligjëratave që i kanë mbajtur të akuzuarit në objektet e fetare, për çka, përkitazi me përmbajtjen e këtyre fjalimeve ka kërkuar edhe mendimin profesional të BIK, por, njëkohësisht ka dëgjuar edhe dëshmitarin S.B., i cili po ashtu, ka dhënë mendimin e tij profesional përkitazi me ligjëratat në fjalë, pastaj, ka marrë parasysh edhe provat kundërtënësë, gjegjësisht përgjigjen me shkrim të BIK-ut, duke përfshirë edhe pjesën kundërtënësë të përgjigjes në fjalë dhe pasi bënë krahasimin e asaj pjese me deklaratën e dëshmitarit S.B., por edhe pjesën tjetër të përgjigjes me shkrim të BIK-ut, konstaton se në bazë të ligjëratave në fjalë nuk mund të konstatohet se të akuzuarit kanë ndërmarrë ndonjë veprim konkret inkriminues në drejtim të veprave penale për të cilët kanë qenë të akuzuar, konkludime këto të cilat si të drejta dhe të ligjshme i aprovon edhe kjo gjykatë. Po ashtu, kur është fjala për të akuzuarin F.R., gjykata e shkallës së parë, ka marrë parasysh përmbajtjen e intervistës së tij të paraqitur në TV, intervistë kjo, që është postuar edhe në mjetet tjera sociale dhe atë intervistë kjo e dhënë në cilësinë e kryetarit të partisë politike “lëvizja islame bashkohu”, ku nga një përmbajtja e intervistës në fjalë, ka konstatuar se nuk rezultojnë të vërtetuara faktet dhe rrethanat e përshkruara më detajisht si në dispozitiv të aktakuzës, prandaj edhe për këtë të akuzuar ka konstatuar se nuk mund të vërtetohet se me dhënien e intervistës në fjalë, i akuzuari të ketë bërë thirrje për rezistencë, sikur që pretendohet në aktakuzë, por edhe tani me ankesë. Prandaj, konstatimi se me provat e proceduara në shqyrtimin gjyqësor nuk është vërtetuar se të akuzuarit kanë ndërmarrë ndonjë veprim inkriminues në drejtim të veprave penale shtytja në kryerjen e veprës terroriste nga neni 141 të KPRK-së, për të akuzuarit B.R. dhe I.B., për të akuzuarit E.G. dhe M.M., për shkak të veprës penale, nxitje e urrejtjes, përçarjes ose mos durimit kombëtar, racor, fetar etnik nga neni 147 par. 2 lidhur me par. 1 të KPRK-së, dhe për të akuzuarin F.R., për shkak të veprës penale thirrje në rezistencë nga neni 411 par. 1 të KPRK-së, janë të drejta dhe të ligjshme dhe atë kanë mbështetje në prova dhe shkresa tjera të lëndës, për çka, më në detaje përkitazi me këtë do të bëhet fjalë edhe gjatë elaborimit të pretendimeve ankimore përkitazi me gjendjen faktike në këtë çështje penale-juridike.

Pretendimet ankimore përkitazi me vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkelje të ligjit penale dhe gjetjet e gjykatës.

Përkitazi me bazën ankimore vërtetim i gabuar dhe jo i plotë i gjendjes faktike nga Prokuroria Speciale, kontestohet mënyra se si janë vlerësuar provat e proceduara në shqyrtimin gjyqësor nga ana e gjykatës së shkallës së parë, e duke pretenduar kështu se edhe konkludimet e asaj gjykate të nxjerra në bazë të këtyre provave janë të gabuara. Pretendohet se provat në fjalë janë vlerësuar në mënyrë të njëanshme dhe të gabuara dhe se si pasojë e konkludimeve të aprovuara ka rezultuar me shkelje të Ligjit Penal në favor të akuzuarve, për çka, gjykata e shkallës së parë, gabimisht ka vepruar kur vendimin e ka marrë, duke mos marrë parasysh së pari SMS-in, që i është dërguar nga Siria, ku njëri nga pjesëmarrësit në ligjëratat e tij e ka njoftuar se ka mbërrirë në destinacion dhe i kërkon të lutet për atë, pastaj, po ashtu, letrën tjetër, po nga pjesëmarrësi në ligjëratat e tij, i cili pasi arrestohet dhe futet në paraburgim, i dërgon letër të akuzuarit I.B.t, duke i kërkuar që të organizojë ndonjë petition për lirim nga burgu dhe njëkohësisht duke ia tërhequr vërejtjen që të ketë kujdes nga personat që paraqiten si besimtar të devotshëm, pastaj, faktin se deklaratës së dëshmitarit S.B., ia fali besimin por nuk e merr parasysh fare përgjigjen me shkrim të BIK-ut të dt. 04.07.2016, përgjigje kjo që nuk është në përputhje me deklaratën e dëshmitarit në fjalë, prova këto, pra, nga të cilat pa mëdyshje vërtetohet se të akuzuarit i kanë kryer veprat penale që me aktakuzë iu vihen në barrë, për çka, gjykata e shkallës së parë, ka bërë edhe shkelje të ligjit penal, kuptohet në favor të akuzuarve kur të akuzuarit i ka liruar nga akuza e prokurorisë për veprat penale në fjalë.

Gjykata e Apelit, vlerëson se pretendimet ankimore të cekura si më lartë, nuk qëndrojnë, ngase gjykata e shkallës së parë, provat e proceduara i ka vlerësuar me përputhje me dispozitat e nenit 361 të KPPK-së, kështu që drejt i ka vlerësuar dhe analizuar faktet vendimtare, përkitazi me këtë në këtë çështje penalo-juridike në mënyrë të pa dyshimë ka vërtetuar gjendjen faktike në bazë të së cilës edhe i ka liruar të akuzuarit nga

akuzat dhe atë: të akuzuarit B.R. dhe I.B., për shkak të veprave penale, për se cilin veç e veç shtytja në kryerjen e veprës terroriste nga neni 141 të KPRK-së, të akuzuarit E.G. dhe M.M., për shkak të veprës penale, për secilin veç e veç, nxitje e urrejtjes, përçarjes ose mos durimit kombëtar, racor, fetar etnik nga neni 147 par. 2 lidhur me par. 1 të KPRK-së, dhe të akuzuarin F.R., për shkak të veprës penale thirrje për rezistencë nga neni 411 par. 1 të KPRK-së.

Në rastin konkret me provat e proceduara në shqyrtimin gjyqësor në mënyrë të pa kontestuar gjykata e shkallës së parë, ka vërtetuar se të akuzuarit B.R., I.B., E.G. dhe M.M., kanë ligjëruar në objekte të ndryshme fetare dhe atë duke komentuar pjesë të ndryshme të kuranit por edhe të librave tjera të besimit islam, pra, kanë mbajtur ligjërata përkitazi me fenë islame dhe atë i akuzuari B.R., në xhaminë e improvizuar në Prishtinë, te v. q. "Termokosi", i akuzuari I.B., në Prizren dhe vende tjera të Kosovës, i akuzuari E.G., në xhaminë e Pejës dhe M.M. në Prizren, në xhaminë "...", ligjërata këto te cilat njëkohësisht janë interpretuar edhe në rrjetet e ndryshme sociale, ku po ashtu, përveç, pjesëmarrësve të shumtë të qytetarëve të paidentifikuar në këto ligjërata kanë marrë pjesë edhe disa nga personat të cilët, pastaj, kanë shkuar në Siri, për të luftuar, ku disa nga ata në luftime e sipër edhe janë vrarë e disa nga ta janë kthyer sërish në Kosovë, ku për shkak të pjesëmarrjes në grupe terroriste në Siri, edhe janë paraburgosur. Faktet dhe rrethanat në fjalë, përveç, që nuk i kanë mohuar vetë të akuzuarit janë vërtetuar edhe përmes deklaratave të dëshmitarëve, por, edhe provave materiale në shkresa të lëndës, si CD-et, SMS-at, foto dokumentacioni dhe shkresat tjera në lëndë. Po ashtu, në mënyrë të pa kontestuar por edhe provat materiale në shkresa të lëndës, gjykata e shkallës së parë, ka vërtetuar se i akuzuari F.R., gjatë paraqitjes së tij në një emision të TV-së, ka dhënë intervistë dhe atë në cilësinë e kryetarit të subjektit politik "lëvizja islam bashkohu", e cila intervistë është postuar edhe nëpër rrjetet sociale, ku i akuzuari ka paraqitur vërejtjet e tij përkitazi me sjelljet e organeve të shtetit të Kosovës, ndaj besimtarëve të fesë islame, sidomos ka bërë vërejtje përkitazi me arrestimin edhe të disa nga imamëve të Bashkësisë Islame nëpër xhamia të Kosovës. Ndërsa, përkitazi me faktet kontestuese se të akuzuarit B.R. e I.B., secili veç e veç, a kanë kryer vepër penale shtytja në kryerjen e veprave terroriste nga neni 141 të KPRK-së, ndërsa, të akuzuarit E.G. dhe M.M., se a kanë kryer veprat penale, secili veç e veç, nxitje e urrejtjes – përçarjes, mos durimit kombëtar, racor dhe fetar apo etnik nga neni 147 par. 2 e lidhur me par. 1 të KPRK-së, dhe i akuzuari F.R., a ka kryer vepër penale thirrje për rezistencë nga neni 411 par. 1 të KPRK-së, gjykata e shkallës së parë, përveç mbrojtjes së të akuzuarve, të cilët nuk i kanë kontestuar faktet dhe rrethanat që u cekën më lartë, ka marrë për bazë së pari, deklaratën e të akuzuarve të cilët kanë deklaruar se me personat që kanë marrë pjesë në luftë nuk kanë pasur kurrfarë lidhje direkte, pastaj se ligjëratat të cilat i kanë mbajtur kanë qenë kryesisht të karakterit edukues në aspektin fetar, e jo nxitje për të marrë pjesë në luftëra e aq më pak në organizatat terroriste, fakte këto dhe rrethana që gjykata e shkallës së parë, i ka vërtetuar edhe përmes përgjigjes me shkrim të BIK-ut, pastaj, edhe vetë deklaratës së dëshmitarit S.B. - kryeimam i BIK-ut, ku ka dhënë sqarime në aspektin fetar përkitazi me ligjëratat që janë mbajtur nga të akuzuarit, i cili në deklaratën e tij ka sqaruar se nga përmbajtja e ligjërimëve në fjalë rezulton se është bërë komentimi i përmbajtjes së kuranit – libër ky i shenjtë islam dhe kuptohet pjesëve të ndryshme të këtij libri, mirëpo, nuk mund të konsiderohet se me këtë është bërë thirrje për pjesëmarrje në luftëra apo që me veprimet e të akuzuarve të kenë shkaktuar përçarje dhe mos durim nacional. Po ashtu, përveç përgjigjes me shkrim të BIK-ut, dhe deklaratës së kryeimamit të BIK-ut-S.B., gjykata e shkallës së parë, ka marrë parasysht edhe provat materiale dhe atë së pari video incizimet, ku është paraqitur përmbajtja e ligjëratave që i kanë mbajtur të akuzuarit, pastaj, foto dokumentacioni, ku vërtetohet numri i pjesëmarrësve në këto tubime – kryesisht nëpër xhamia, por edhe numri i personave të identifikuar, ku disa nga ata edhe kanë shkuar në Siri, dhe janë futur në radhët e organizatave terroriste si ISIS etj., pastaj, raportet e vëzhgimeve të përpiluara nga policët hetues, raporte këto nga të cilat nuk rezultojnë të vërtetuara faktet dhe rrethanat përkitazi me kontaktet e të akuzuarve me personat që kanë shkuar në Siri, që do të thotë se përveç faktit se personat në fjalë kanë qenë pjesëmarrës në tubimet ku kanë mbajtur ligjërata të akuzuarit, me asnjë provë tjetër në shkresa të lëndës nuk vërtetohet se të akuzuarit kanë pasur kontakte apo bisedime të drejta për drejta përkitazi me shkuarjen e tyre në Siri, për çka, pastaj, gjykata e shkallës së parë, edhe ka konstatuar se në veprimet e të akuzuarve B.R. dhe I.B., nuk përmbushen elementet e veprave penale, për secilin veç e veç, shtytja në kryerjen e veprës terroriste nga neni 141 të KPRK-së, ndërsa, për të akuzuarit

E.G. dhe M.M., për shkak të veprës penale, secili veç e veç, nxitje e urrejtjes, përçarjes ose mos durimit kombëtar, racor, fetar etnik nga neni 147 par. 2 lidhur me par. 1 të KPRK-së, dhe për të akuzuarin F.R., për shkak të veprës penale thirrje në rezistencë nga neni 411 par. 1 të KPRK-së, konkludime këto të cilat si të drejta dhe të logjikshme i aprovon edhe kjo gjykatë, që do të thotë se drejtë është aplikuar edhe ligji penal dhe nuk ka shkelje të ligjit penal, në favor të akuzuarve, sikur që pretendohet në ankesë.

Prandaj, duke pasur parasysh atë që u tha më lartë, kjo gjykatë vlerëson se me të drejtë gjykata e shkallës së parë, ka konstatuar se me provat e proceduara në seancën e shqyrtimit gjyqësor, nuk është vërtetuar se të akuzuarit kanë kryer veprat penale dhe atë; të akuzuarit B.R. dhe I.B., shtytja në kryerjen e veprës terroriste nga neni 141 të KPRK-së, ndërsa, të akuzuarit E.G. dhe M.M., nxitje e urrejtjes, përçarjes ose mos durimit kombëtar, racor, fetar etnik nga neni 147 par. 2 lidhur me par. 1 të KPRK-së, dhe i akuzuari F.R., thirrje për rezistencë nga neni 411 par. 1 të KPRK-së, ngase përveç, pretendimeve në aktakuzë, se të akuzuarit kanë ndërmarrë veprime inkriminuese në drejtim të veprave penale për të cilat janë akuzuar, me asnjë provë në shkresa të lëndës por as tani me ankesë, prokuroria nuk ka ofruar fakte dhe rrethana të argumentuara që do të mund të kualifikoheshin si shtytje për pjesëmarrje në grupet terroriste apo veprime inkriminuese që do të nxisnin përçarje dhe mos durim nacional, gjegjësisht, veprime inkriminuese që do të mund të kualifikoheshin si thirrje për rezistencë, prandaj, pretendimet ankimore të Prokurorisë Speciale, se të akuzuarit është dashur të shpallen fajtorë për këto vepra penale, qartazi janë të pa bazuara e pa mbështetje në prova dhe në shkresa tjera të lëndës.

Nga çka u tha më lartë, e konform dispozitës së nenit 401 të KPPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PAKR.nr.455/2018, të dt. 09.11.2018

Procesmbajtse,
Syzana Goxhuli

Anëtarët e kolegjit,
1. Xhevdet Abazi

Kryetari i kolegjit,
Fillim Skoro

2. Afrim Shala
